

VENDIM
Nr. 105, datë 30.4.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MALËSIA SOLAR 1” SHPK NË AKTIVITETIN E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
“LAHË E POSHTME”, SHKREL, KOPLIK, RRETHI MALËSI E MADHE, QARKU
SHKODËR, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2.5 mw**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; nenit 5, pika 1, germa “a”; nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Lahë e Poshtme” Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 236 prot., datë 7.3.2018, shoqëria “Malësia Solar 1” sh.p.k., paraqiti në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, “Lahë e Poshtme”, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, për një afat 25-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 61, datë 26.3.2018, u shpreh për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Lahë e Poshtme”, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar.

- Në vijim të vendimit të sipërcituar, ERE, me shkresën nr. 55/16 prot., datë 27.3.2018, publikoi në median e shkruar, njoftimin për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik dhe mbas përfundimit të afatit 20 ditë të paraqitjes së objeksioneve ose të ankesave, lidhur për sa publikuar, nuk rezulton të jetë paraqitur në ERE, ankesë ose objeksion nga subjekte ose persona fizikë.

- Aplikimi i shoqërisë “Malësia Solar 1” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”, 4.1.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, 4.1.5, gjerat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Malësia Solar 1” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, “Lahë e Poshtme”, Shkrel, Koplik, rrethi Malësi e Madhe, qarku Shkodër me fuqi të instaluar 2.5 mw, për një afat 25-vjeçar (njëzetepesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti